



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë, 22.08.2013
Nr. 0204-1122

PËR: Isa Mustafa, Kryetar i Komunës së Prishtinës
Sami Hamiti, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prishtinës

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË PRISHTINËS, Nr. 031 -125581 të pranuar me datën 21.08.2013

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin Nr. 2003/14 për Planifikim Hapësinor, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare, Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit Nr. 031 -125581, të miratuar me datë 23.07.2013 nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës, **KONFIRMON** ligjshmërinë e aktit dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i cili prodhon efekt të plotë juridik:

- Vendim Nr. 031 -125581, për lënien në dispozicion për diskutim publik të propozimplanit rregullues urban të lagjes "Prishtina e Re - Zona Lindje".

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër & Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Dana: 20.08.2013
Br. 0204 - 1122

Za : Isa Mustafa, Gradonačelnik Opštine Priština.
Sami Hamiti, Predsedavajući Skupštine Opštine Priština.

PREDMET: POTVRDA ZAKONITOSTI UREBE OPŠTINE PRIŠTINA
, Nr. 031-125581, Prilmljeno dana,21.08.2013

Poštovani,

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom odredjenim po Zakonu za lokalnu samoupravunë Br. 03/L-040, dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta Premjera i Ministarstva, posle razmatranja Uredbe Br. 031-125581, usvojene dana 23.07.2013, od Skupštine Opštine Novo Priština **POTVRDJUJE** zakonitost ovog akta i ceni da je isti u skladu sa Zakonom Br.03/L- 040 za lokalnu samoupravu .

Pravni Akt niže neveden,ima puni pravni efekat.

- Odluka br. 031-125581 za stavljanje na raspolaganje za javnu diskusiju predloga urbanog regulativnog plana naselja-Nova Priština-Zona Istok.

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamanik premijera & Ministar MALS-a,

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a
Rukovodiocima Uprava MALS-a
Arhivu MALS-a.

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVES VLADY KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVO			
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije Ministry of Local Government Administration			
Data Datum: 23.07.2013			
Date			
Niveli organizatave	Nr. i Lendës	Antares	Vlera
- 11 -	009 - 1120		



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
 Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 17, pika b të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 15, paragrafi 15.1 i Ligjit nr. 2003/14, për planifikimin hapësinor, të nenit 11 të Ligjit nr. 03/L - 106, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për planifikimin hapësinor nr. 2003/14 dhe të nenit 34, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 23.07.2013, miratoi këtë

VENDIM
PËR LËNIEN NË DISPOZICION PËR DISKUTIM PUBLIK TË PROPOZIMPLANIT
RREGULLUES URBAN TË LAGJES "PRISHTINA E RE - ZONA LINDJE"

I.

- Miratohet Vendimi për lënie në dispozicion për diskutim publik të Propozimplanit rregullues urban "Prishtina e Re - Zona Lindje" në Prishtinë.
- Propozimplanit nga pika I e këtij Vendimi, përbëhet nga pjesa tekstuale dhe grafike, të cilat janë pjesë përbërëse të këtij vendimi.

II.

- Propozimplanit rregullues urban, i cekur në pikën I të këtij Vendimi, i lehet në dispozicion për diskutim publik agjencive, departamenteve dhe organeve të tjera për shqyrtim dhe komente, në afat prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e parë vijuese pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
- Organizimin e diskutimit publik të Propozimplanit, do ta bëjë Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës.

III.

- Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës do të kryejë veprimet e parapara ligjore për finalizimin e këtij plani.
- Pas përfundimit të kohës për shqyrtim dhe komente dhe finalizimit të tij, Propozimplanit i dërgohet Kuvendit të Komunës për miratimin final.

IV.

- Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës.
- Organet tjera përkatëse kompetente, do t'i kryejnë veprimet procedurale për zbatim të këtij Propozimplanit nga përgjegjësitë e tyre të parapara në vendimin për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të administratës komunale.

V.

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë nga dita e publikimit të tij në tabelën e shpalljeve dhe ueb-faqen e Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
 01. nr.031-125581, më 23.07.2013

KRYESUESI I KUVENDIT
 Sami Hamiti, eec. i dpl.